

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS - TUZILADEI SAVETI KOSOVA
SEKRETARIATI - SEKRETARIJAT
ARKIVA - ARHIVA

05 -11- 2020

Nr./Br. 1113, 2020

PRISHTINË - PRIŠTINA

UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
ISA BOLETINI
REKTORATI

Pranuar me dt 03.12.2020			
Njesia org	Numer	Nr ekzempli	Vlera
	1965		



KËSHILLI PROKURORIAL
I KOSOVËS



UNIVERSITETI I MITROVICËS
"ISA BOLETINI"

FAKULTETI JURIDIK

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

NË MES TË

KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS
E PËRFAQËSUAR NGA:
BAHRI HYSENI, KRYESUES

DHE

FAKULTETIT JURIDIK TË UNIVERSITETIT PUBLIK TË MITROVICËS
"ISA BOLETINI",
I PËRFAQËSUAR NGA:
PROF.DR. ALUSH MUSAJ, REKTOR

Neni 1 Qëllimi

1. Qëllimi i këtij memorandumi është bashkëpunimi, mbështetja dhe bashkërendimi i aktiviteteve në mes të subjekteve të lartcekura.
2. Memorandumi synon të promovojë përpjekjet e përbashkëta të dy institucioneve në sferën e avancimit të çështjeve me interes reciprok.

Neni 2 Palët në Memorandum

1. Palët në këtë memorandum janë:
 - 1.1 Këshilli Prokurorial i Kosovës;
 - 1.2 Fakulteti Juridik i Universitetit Publik i Mitrovicës "Isa Boletini.

Neni 3 Fushat e Bashkëpunimit

1. Palët e lartcekura do të bashkërendojnë aktivitetet për afirmimin e çështjeve aktuale në fushën e avancimit të jetës akademike dhe profesionale përmes:
 - 1.1 Bashkëpunimit në zhvillimin e moduleve dhe programeve të ndryshme të studimit.
 - 1.2 Realizimit të punës praktike për studentët e Fakultetit Juridik në sistemin prokurorial të Kosovës.
 - 1.3 Shkëmbimet e përvojave, praktikave të mira, ekspertëve dhe literaturës përkatëse për zhvillimin institucional, me qëllim të avancimit profesional dhe akademik të studentëve dhe përfaqësuesëve të Këshillit Prokurorial të Kosovës.
 - 1.4 Hartimin e programeve hulumtuese dhe kërkimore komform kërkesave dhe interesave dypalëshe.
 - 1.5 Organizimin e përbashkët, të veprimtarive shkencore dhe profesionale si: simpoziume, seminare, konferenca, tryeza, shkolla verore, trajnime etj.
 - 1.6 Ndikimi pozitiv në përafrimin e programeve të studimit me nevojat e tregut të punës.
 - 1.7 Mbështetjes teknike dhe organizative dy palëshe.
 - 1.8 Mbajtjes së ligjëratave (me tema të veçanta) nga ana e anëtarëve të Këshillit Prokurorial të Kosovës para studentëve të Fakultetit Juridik dhe stafit akademik të interesuar.

1.9. Botimi i punimeve profesionale dhe akademike të anëtarve të Këshillit Prokurorial të Kosovës në revistën shkencore të Fakultetit Juridik “JUS PUBLICUM – JUS PRIVATUM”, konform standardeve që i përcakton redaksia e revistës.

2.0. Realizimin e formave të ndryshme të bashkëpunimit konform vullnetit dhe interesit të përbashkët.

Neni 4

Palët nënshkruese të këtij Memorandumi të Bashkëpunimit pajtohen si në vijim:

1. Për të pasur qasje në Këshillin Prokurorial të Kosovës personeli akademik dhe studentët e Fakultetit Juridik duhet që paraprakisht ta dërgojnë listën e pjesëmarrësve për miratim të përfaqësuesi i Këshillit Prokurorial i Kosovës.

2. Lista e pjesëmarrësve për vizitë në zyrat e sistemit prokurorial të Kosovës duhet të përmbajë të dhënat si:

2.1 Emrin dhe mbiemrin e pjesëmarrësve;

2.2 Numrin Personal të dokumentit identifikues.

3. Personeli Akademik dhe Studentët me rastin e vizitave në zyrat e sistemit prokurorial të Kosovës, janë të obliguar t'i zbatojnë rregullat e brendshme të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

4. Personeli Akademik dhe Studentët e Fakultetit janë të obliguar që për çdo vizitë të informojnë me kohë përfaqësuesit e sistemit prokurorial, varësisht se ku do të zhvillohet vizita.

5. Studentëve të Fakultetit sipas këtij memorandumi mund t'ju lejohet punë praktike ose hulumtim në sistemin prokurorial, me kërkesë të veçantë.

6. Këshilli Prokurorial i Kosovës i mundëson qasje për vizitë në zyrat e sistemit prokurorial, personelit akademik dhe studentëve të Fakultetit Juridik për fushat e bashkëpunimit sipas këtij Memorandumi dhe në pajtim me legjislacionin në fuqi si dhe rregullat e brendshme të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

7. Personeli Akademik dhe studentët e Fakultetit janë të obliguar ta ruajnë kofidencialitetin e gjatë vizitës në zyrat e sistemit prokurorial të Kosovës sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave.

Neni 5 **Kohëzgjatja**

Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi nga dita e nënshkrimit dhe ka efekte juridike në kohë të pacaktuar, konform vullnetit dhe interesave të përbashkëta.

Neni 6
Ndërprerja

1. Ky memorandum bashkëpunimi mund të ndërpritet:

1.1 Në çdo kohë në rast të mos respektimit të pikave të marrëveshjes nga të dyja palët.

1.2 Me paralajmërim me shkrim së paku 30 ditë para datës së ndërprerjes së marrëveshjes.

Neni 7
Ndryshimi dhe amendamenti

Ky memorandum bashkëpunimi mund të rishikohet, ndryshohet dhe plotësohet në bazë të pajtimit paraprak ndërmjet palëve nënshkruese.

Neni 8
Ekzemplarët e Memorandumit

Ky Memorandum Bashkëpunimi nënshkruhet në dy ekzemplarë të njëjtë nga një ekzemplarë për secilën palë.

Neni 9
Hyrja në Fuqi


Ky Memorandum Bashkëpunimi hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruese.

PALËT:

Këshilli Prokurorial i Kosovës

Kryesues,

Bahri Hyseni



**Fakulteti Juridik i Universitetit Publik
të Mitrovicës "Isa Boletini"**

Rektor,

Prof. Dr. Alush Musaj

